



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 33/16 Prot.

Tiranë, më 07.10.2022

V E N D I M

Nr. 126, datë, 07 . 10. 2022

PËR PUSHIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim të oficerit të policisë gjyqësore Ervis Balla, dëgjoi pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1.Mbi kërkesën e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, “Për procedimin disiplinor të oficerit të Policisë Gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Ervis Balla, protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore me numër protokolli 33, datë 12.07.2022, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka nxjerrë Urdhërin nr.80, datë 21.07.2022 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier , Ervis Balla”, për kryerjen e shkeljeve disiplinore, “Kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”, të parashikuar nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 4, gërma “ç”.

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit Andi Pogaçe dhe relacioni shoqërues, rezulton se si bazë për kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale nga ana e oficerit të policisë gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier , Ervis Balla, gjatë hetimit të procedimit penal nr. 459, regjistruar në datën 09.05.2022, në ngarkim të shtetasit

Astrit Selamaj, për veprën penale “ Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal.

Nga aktet që u administruan gjatë seancës dëgjimore për procedimin disiplinor, rezulton se:

2.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, në datën 09.05.2022 ka regjistruar procedimin penal Nr. 459, në ngarkim të shtetasit Astrit Selamaj, për veprën penale “ Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal.

Veprimet e para hetimore dhe referimi i materialeve në Prokurori janë kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Ervis Balla.

2.2 Nga aktet e procedimit penal rezulton se në datën 19.04.2022, në fshatin Vajkan automjeti tip Hyundai, i drejtuar nga shtetasi Astrit Selamaj, ka dalë nga rruga duke përfunduar në tokën arrë anash rrugës. Në këtë automjet bashkë me drejtuesin e mjetit, udhëtonin dhe familjarët e tij, bashkëshortja Bejushe Selamaj, bashkëshortja e djalit dhe nipi. Organet e policisë kanë gjetur në vendin e ngjarjes drejtuesin e mjetit, ndërsa familjarët e tij ishin larguar për në spitalin e Fierit për ndihmë mjekësore.

I pyetur për ngjarjen, drejtuesi i mjetit Astrit Selamaj, ka shpjeguar se ditën e ngjarjes është nisur nga qyteti i Tiranës së bashku me familjarët e tij për në qytetin e Vlorës. Në afërsi të fshatit Vajkan, kanë parë para tyre një motomjet i cili lëvizte në rrugë normalisht. Në një moment motomjeti ka filluar të bënte lëvizje në mënyrë të çregullt dhe filloi të kryente manovra duke i zënë rrugën automjetit që ai drejtonte. Shtetasi Astrit Selmanaj shpjegon se duke parë lëvizjet e motomjetit, me qëllim për të mos e goditur atë, ka filluar të manovrojë me sistemin e frenimit dhe sistemin e drejtimit, por si pasojë e kësaj, mjeti i drejtuar prej tij ka dalë nga rruga duke përfunduar në fushën anës rrugës. Si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar dëmtime bashkëshortja e drejtuesit të mjetit, shtetasja Bejushe Selmanaj.

2.3 Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, parashtrohet se, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Ervis Balla edhe pse ai ka konstatuar se në automjetin e drejtuar nga shtetasi Astrit Selmanaj kanë qenë dhe persona të tjerë, edhe pse ka ardhur në dijeni të faktit se disa prej këtyre personave janë paraqitur në spitalin e qytetit të Fierit për ndihmë mjekësore, edhe pse ka referuar faktin për veprën penale të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, nuk ka marrë asnjë vendim për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor për këta shtetas. Në vijim, vetë shtetasja Bejushe Selmanaj ka kërkuar aktet e ekspertimit mjeko ligjor për dëmtimet që ka pësuar.

Sipas kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Ervis Balla janë kryer shkeljet ligjore dhe procedurale:

- Rezulton se oficeri i policisë gjyqësore Ervis Balla nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për evidentimin e dëmtimeve që kishin pësuar pasagjerët që ndodheshin në automjetin e aksidentuar duke vendosur kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të tyre, por e referon ngjarjen si fakt kriminal të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal.

- Si pasojë e moskryerjes së veprimeve të domosdoshme hetimore nuk është bërë dot e mundur evidentimi i pasojave të lehta që dyshohet se kanë marrë viktimat e kësaj ngjarje të cilët ishin pasagjer në automjetin e drejtuar nga i dyshuari Astrit Selamaj.

2.4 Këto veprime dhe shkelje të kërkesave të ligjit të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Ervis Balla, nga ana e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, konsiderohen si shkelje disiplinore në formën ”:

“Kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Procedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”, të parashikuara si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 4, gërma ”ç” e këtij ligji.

3. Komisioni i Policisë Gjyqësore, në funksion të një procesi të rregullt dhe të plotë ligjor, me qëllim sqarimin e plotë të shkeljeve disiplinore dhe rrethanave në të cilat janë kryer ato, të parashtruara nga Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, në kërkesën propozim për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore Ervis Balla, administroi aktet nga procedimi penal 459, regjistruar në datën 09.05.2022, në ngarkim të shtetasit Astrit Selamaj, bashkalidhur kërkesës së Prokurorit Andi Pogaçe, dëgjoi shpjegimet e subjektit të proceduar Ervis Balla, dhe administroi të dhënat nga dosja personale e oficerit të policisë gjyqësore Ervis Balla. Nga analiza e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit, Komisioni i Policisë Gjyqësore, arrin në përfundimin se nuk provohet që nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Ervis Balla të jenë kryer shkeljet disiplinore të parashtruara nga prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe.

Shkelja disiplinore pretenduar nga Prokurori në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, “kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Procedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”, e parashikuar nga neni 33, pika 4, gërma “ç”, që të konsiderohet e konsumuar, kërkohet që të ekzistojnë njëkohësisht dy kushte:

E para – të vërtetohet kryerja nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore, e veprimeve dhe mosveprimeve, në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të K.Pr.Penale,.

E dyta – Nga kryerja e këtyre veprimeve apo mosveprimeve, të kenë ardhur pasoja për hetimin e çështjes.

Nga aktet e administruara gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor, aktet e procedimit penal, të cilat shoqërojnë kërkesën e prokurorit Andi Pogaçe, shpjegimet e subjektit të proceduar Ervis Balla, dhe provat që ai dorëzoi në séance dëgjimore, nuk provohet asnjë nga dy kushtet e mësipërme. Thelbi i shkeljes së pretenduar nga prokurori është se oficeri i policisë gjyqësore Ervis Balla nuk ka kryer veprime konkrete për evidentimin e dëmtimeve që kishin pësuar pasagjerët që udhëtonin me mjetin e aksidentuar, dhe se nga ky mosveprim i tij, nuk është bërë e mundur evidentimi i pasojave të lehta që dyshohej se kishin marrë viktimat e kësaj ngjarje,

3.1 Nga ana e subjektit propozues, prokurorit Andi Pogaçe nuk është paraqitur asnjë prove që provon pretendimet e tij. Propozimit të tij për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore Ervis Balla, i janë bashkëlidhur vetëm aktet e procedimit penal, që janë përpiluar nga oficeri i Policisë Gjyqësore Ervis Balla gjatë kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, menjëherë pas ngjarjes. Nga përmbajtja e këtyre akteve, nuk mund të konkludohet për kryerjen e shkeljes disiplinore nga oficeri Ervis Balla.

Subjekti propozues nuk ka paraqitur asnjë aktë apo prove që atij i ka rezultuar nga veprimet e mëvonshme hetimore, të cilat provojnë se personat që udhëtonin me automjetin që pësoi aksidentin janë dëmtuar dhe cila është shkalla e dëmtimit të tyre.

3.2 Nga ana tjetër, lidhur me shkeljet e pretenduara, oficeri i Policisë Gjyqësore Ervis Balla shpjegoi në séance dëgjimore se:

“Ditën e ngjarjes kam qenë në punë, Jam njoftuar se ka ndodhur një aksident dhe se nga vendi i ngjarjes është nisur ambulanca e cila po transportonte për në spital, personat e përfshirë në aksident. Në spital me ambulancë ka ardhur një person i dëmtuar dhe jo tre persona. Dy personat e tjerë nuk kanë patur asnjë dëmtim dhe nuk kanë kryer asnjë ekzaminim, dhe as kanë marrë mjekim. Bëhet fjalë për nusen e djalit të drejtuesit të mjetit dhe një fëmijë i vogël. I dëmtuar ka qenë vetëm pasagjerja e vendit të parë, Vejushë Selimaj, ... Kam hartuar vendimin për ekspertimin mjekoligjor për të dëmtuarin, Vejushë Selimaj. Vendimin nuk e kam çuar me shkrese përcjellëse. Është marrë dhe akti mjekoligjor me dëmtimet që ka pasur... Është e sigurtë që dy personat e tjerë nuk kanë pasur asnjë dëmtim. Kam qenë aty, madje kam pyetur edhe zonjën nëse kishte ndonjë problem, ndonjë shqetësim dhe me ka pohuar që nuk kam asgjë, po ashtu edhe fëmija ska pasur asnjë dëmtim. Kam bërë referimin dhe e kam referuar për nenin 290/1 të Kodit Penal dhe kam menduar me aq njohuri sa unë kam se duke qenë 290/1 se skam pasur mundësi për deklarinimin e zonjës skam pasur mundësinë as për ankimim as për të hequr dorë. Gjithmonë ngjarjet rrugore kanë këto çështjet e siguracioneve e kam menduar për ta nisur për 290/1 që të gjithë materialet të jenë në prokurori dhe të jetë ngjarje e dokumentuar.... Mjekët më kanë thënë që nuk ka problem zonja, do ketë kontrolle dhe kaq.... Me ambulance kanë ardhur të tre personat bashkë por mjekim ka marrë vetëm zonja, ndërsa dy personat e tjerë nuk kanë marrë mjekim.

...sa herë që bëhen testet e alkolit përgjithësisht i bëjmë video për të treguar gjëndjen e personave të dëmtuar dhe unë kam të dokumentuar me video momentin kur tek spitali i kamë bërë provën drejtuesit të mjetit dhe në këtë video janë të fiksuar veç drejtuesit të mjetit edhe nipi i tij dhe bashkëshortja e djalit. Nga video dallohet qartë që, si nipi ashtu edhe bashkëshortja e djalit nuk kanë dëmtime.

Gjithashtu oficeri i policisë gjyqësore shpjegoi se disponon kopje të vendimit të ekspertimit mjekoligjor të personit të dëmtuar Vejushë Selimaj, dhe aktin e ekspertimit. Ketë akt ja ka dërguar mjeku ligjor nga mesi i muajit Korrik, dhe sipas tij, e ka mbajtur vetë në pritje që prokurori ti delegonte dosjen për hetim.

3.3 Oficeri i Policisë Gjyqësore Ervis Balla paraqiti dhe dorëzoi si prove pranë Komisionit një fotografi, duke shpjeguar se në fotografi janë fiksuar djali dhe nëna e tij, të cilët kanë qenë pasagjer në automjet. Nga fotografia evidentohet fakti që ata nuk kanë dëmtime. Ata janë

fotografuar në spital në një nga sallat e pritjes së urgjencës. Subjekti i proceduar shpjegoi se me këtë fotografi vërtetohet se nuk ishte e nevojshme të merrte vendim ekspertimi mjekoligjor për ta, sepse nuk kishin dëmtime.

3.4 Gjithashtu, oficeri i Policisë Gjyqësore Ervis Balla paraqiti dhe dorëzoi si provë në favour të tij, një vendim për kryerjen e ekspertimit mjeko – ligjor, i cili mban datën 19.04.2021 dhe me të cilin ka kërkuar nga mjeku ligjor Blerim Peli të kryej ekspertimin mjeko – ligjor për të dëmtuarën, Bejushe Selamaj, si dhe Akt ekspertimin mjeko – ligjor, nr.56/k, datë 22.06.2022, lëshuar nga mjeku ligjor, Blerim Pei, në të cilin përshkruhen dëmtimet që ka pësuar nga aksidenti, shtetasja Bejushe Selamaj.

4. Në përfundim, në analizë dhe vlerësim të akteve të administruar gjatë shqyrtimit të procesit disiplinor, përfshirë dhe sqarimet dhe shpjegimet e subjektit të procedimit disiplinor, Komisioni i Policisë Gjyqësore, arrin në përfundimin se shkeljet disiplinore të parashtruara si të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore Koçi Gega, nuk provohen. Pretendimi i prokurorit se meqëse oficeri i Policisë Gjyqësore Ervis Balla nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për evidentimin e dëmtimeve që kishin pësuar pasagjerët në automjet, sepse nuk ka vendosur kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të tyre, ngelet thjesht në kuadrin e dyshimeve që nuk shoqërohet me prova bindëse.

Në asnjë dispozitë të Kodit të Proçedurës Penale nuk parashikohet asnjë detyrim për oficerin e policisë gjyqësore, për të kryer ekspertimin mjekoligjor për të gjithë personat që janë përfshirë në një aksident rrugor, kur ata nuk ankohen për dëmtime dhe dukshëm dallohet se nuk kanë pësuar dëmtime.

Veç sa sipër, sikurse parashtruam dhe më lartë, kërkesa e prokurorit Andi Pogaçe nuk shoqërohet me asnjë provë që ka rezultuar nga veprimet e mëvonshme hetimore, të cilat do sillnin ndonjë të dhënë në favor të pretendimeve të tij.

5. Në rastet kur shkeljet disiplinore nuk provohen ose nuk qëndrojnë, referuar nenit 38 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” dhe nenit 13 të Rregullores nr.10, datë 21.04.2020 “Për proçedimin disiplinor”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, Komisioni duhet të pushojë proçedimin disiplinor.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”, 11, pika 4 dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore me 4 vota pro.

V E N D O S I:

- 1.** Pushimin e proçedimit disiplinor ndaj Oficerit të Policisë Gjyqësore Ervis Balla, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier.
- 2.** Me këtë vendim të njihet oficeri i policisë gjyqësore Ervis Balla.

3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen, Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI

ANËTAR

ARJAN MUÇA

ANËTAR

HARI GOGO

Mungo



ANËTAR

REDI VASILI

ANËTAR

ALBERT MUÇO

Muço